**VENDIM**
**Nr. 93, datë 22.2.2023**

# PËR PJESËMARRJEN E PERSONELIT TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË OPERACIONIN E NATO-s "FOCOPS", NË DETIN MESDHE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 7, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005, "Për dërgimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, si dhe për mënyrën e procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë", dhe të shkronjës "ç", të nenit 11, të ligjit nr. 64/2014, "Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dërgimin e 1 (një) anijeje të klasit "Iliria", e kompletuar me efektivë, të përbërë nga 21 (njëzet e një) ushtarakë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, në operacionin e NATO-s "FOCOPS", pjesë e operacionit "*Sea Guardian*", në Detin Mesdhe.

2. Misioni i anijes është kryerja e detyrave të patrullimit, zbulimit detar, dhënies së ndihmës, njohjes së situatës detare, identifikimit, verifikimit, ndalimit të objekteve detare, në përbërje të grupit të gatshëm të anijeve të NATO-s, *Standing NATO Maritime Group*-2 (SNMG2), në detin Adriatik dhe në detin Jon (Deti Mesdhe), në kuadër të operacionit të NATOS-s, "*Sea Guardian*", në Detin Mesdhe.

3. Komandimi operacional i anijes gjatë periudhës së angazhimit në operacion kryhet nga komandanti i grupit të gatshëm të anijeve të NATO-s, SNMG2. Për çdo rast, anija ruan varësinë në nivelin kombëtar, duke raportuar në mënyrë periodike për mbarëvajtjen e operacionit.

4. Kohëzgjatja e këtij operacioni është deri në 20 (njëzet) ditë, afat i cili fillon të llogaritet nga data e dërgimit të anijes në operacion.

5. Ministria e Mbrojtjes përballon shpenzimet për personelin pjesëmarrës në këtë operacion dhe për anijen, për:

a) dieta për ditët e qëndrimit, në masën 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë në ditë, përveç pagës mujore;

b) sigurimin e jetës;

c) ushqim;

ç) sigurimin e anijes;

d) siguracion shëndetësor jashtë zonës së operacionit;

dh) mbështetje shëndetësore;

e) shpenzime për telefon, internet dhe shërbime postare;

ë) karburant, lubrifikante;

f) transport personeli për në zonën e operacionit;

g) aktivitete social-kulturore në rastet e festave kombëtare, gjatë kohës së kryerjes së operacionit;

gj) transportimin e individëve të shkëputur nga operacioni për në atdhe, në rast vdekjeje, sëmundjeje ose thyerjeje disipline;

h) taksa portuale, shërbime portuale dhe të kalimit nëpër ngushtica;

i) riparim të nivelit të dytë pas kthimit nga operacioni;

j) çdo shpenzim tjetër për mbarëvajtjen e kryerjes së operacionit.

6. Transporti i personelit të anijes që merr pjesë në operacion, ndërsa nis, ndryshon dhe përfundon detyrën, për t'u kthyer në Shqipëri, mbështetja shëndetësore, akomodimi, ushqimi, lavanderia, transporti i individëve të shkëputur të operacionit për në atdhe, në rast vdekjeje,

sëmundjeje ose thyerjeje disipline përballohen nga pala shqiptare, përveç rasteve kur arrihet nënshkrimi i marrëveshjeve dypalëshe, ku pala tjetër merr përsipër këto shpenzime.

7. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga fondet e miratuara në buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes.

8. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**